



AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“GEO CONSULTING” Sh.p.k

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “GEO CONSULTING” Sh.p.k e cila me poshte do te quhet “SHOQERIA” themelohet nga ortaku i vetem **Z.Edmond Lekaj**, shtetas shqiptar, lindur ne Erseke (Kolonje) me 08 shkurt 1961, banues ne Rr. “Aleksander Moisiu”, Tirane , mbajtes i pasaportes me nr. 0422898

Neni 1
Emertimi

- 1.1 Shoqeria emertohet “GEO CONSULTING” sh.p.k.

Neni 2
Forma-Baza ligjore

- 2.1 Shoqeria do te jete e formes me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k).
- 2.2 Shoqeria. do te kryeje veprimtarine e saj ne perputhje me ligjin nr. 7638 date 19 Nentor 1992 “Per shoqerite tregtare” dhe dispozitat e tjera te legjislacionit shqiptar.

Neni 3
Kohezgjatja

- 3.1 Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe pa afat.
- 3.2 Ortaku i vetem gezon te drejten ta prishe shoqerine ne cdo kohe.

Neni 4
Selia

- 4.1 Selia e shoqerise do te jete ,Sheshi “Skenderbe”,Pallati Kultures, Tirane,Shqiperi.
- 4.2 Selia mund te ndryshohet me vendim te Ortakut te vetem.



4.3 Shoqëria ka te drejte te krijojë dege, filiale ose / dhe zyra perfaqesimi ne te gjithe territorin e Republikës se Shqipërisë, dhe jashte vendit.

4.4 Vendimi per krijimin ose edhe mbylljen e tyre meret nga Ortaku i vetem.

Neni 5 Objekti

5.1 Objekti i veprimtarisë se shoqërisë do te perfshijë: Konsulencë teknike, shërbime, projektim e zbatim, revizion dhe tregetim ne fushat: punime topogjeodezike, gjeodezi inxhinierike, hartografi, fotogrametri, sistemet e informacioneve gjeografike, pasurite e palujtshme.

5.2 Objekti i shoqërisë mund te zgjerohet ose ndryshoje me vendim te ortakut te vetem.

Neni 6 Kapitali

6.1 Kapitali i shoqërisë ne ditën e krijimit te saj eshte 100 000 (nje qind mije) leke, teresisht i shlyer nga ortakut i vetem. Pjeset e kapitalit zoterohen te tera nga Ortaku i vetem

6.2 Kapitali eshte ndare ne 100 (njeqind) pjese, secila me vlerë nominale 1000 leke (nje mije).

6.3 Kapitali mund te zmadhohet ne cdo kohe me vendim te Ortakut te vetem

Neni 7 Administrimi

7.1 Shoqëria do te administrohet nga Ortaku i vetem z Edmond Lekaj.

7.2 Administratori do te veproje ne baze te rregullave te percaktuara ne Statut.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 8 Likuidimi

8.1 Shoqëria do te likujdohet, ne rast prishjeje, sipas rregullave te percaktuara ne Statutin e saj.

